



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 1090 Prot.

Tiranë, më 04.09.2024

URDHËR

Nr. 8, DATË 04/09/2024

MBI

**“CAKTIMIN E DATËS 6 SHTATOR 2024 DITË PUSHIMI PËR STAFIN
ADMINISTRATIV NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Në mbështetje të nenit 87 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 3 dhe 39 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 145, datë, 10.03.2021 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë” si dhe nenit 27, pika 2 të Statutit të Universitetit të Arteve,

URDHËROJ:

1. Caktimin e datës **6 Shtator 2024, ditë pushimi** për stafin administrativ në të gjitha njësitë përbërëse të Universitetit të Arteve.
2. Data 6 Shtator 2024 do të konsiderohet kompensim i ditës së shtunë, datë 17 Gusht 2024, ku stafi administrativ është angazhuar në punë për efekt të regjistrimit në konkurset e pranimit në Universitetin e Arteve.
3. Provimet e sezonit të vjeshtës, të planifikuara në datat 5 dhe 6 Shtator të shtyhen sipas agjendës së fakulteteve dhe këto të fundit të njoftojnë në rrugë zyrtare datat e reja.
4. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore IS/P-A si dhe Sektori i Teknologjisë së Informacionit të Universitetit të Arteve ngarkohen me detyrën e njoftimit të këtij urdhri.
5. Ky urdhër të publikohet në faqen zyrtare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Erald BAKALLI

